

# RAPORT VLERESIMI

## Pasurinë Nr. 237/4 e Llojit Kullotë

Qerekë Krujë

**POROSITËSI:** Shoqëria "Belle Air" shpk, shoqëri në falimentim

*Sipas Kërkesës së Administratores së Falimentimit të  
shoqërisë "Belle Air" sh.p.k. Znj. Shpresa Breçani*

**Pergatitur nga :** **EKSPERT VPP Artur SULÇE**  
**EKSPERTE VPP Etleva SELIMAJ**



**TIRANË**

**17.12.2020**

## P Ë R M B A J T J A

<b>A. INSTRUKSIONE</b> .....	<b>3</b>
<b>B. QËLLIMI</b> .....	<b>4</b>
<b>RAPORTI I VLERËSIMIT</b> .....	<b>5</b>
<b>KAPITULLI I</b> .....	<b>5</b>
1.1 Adresa dhe prona .....	5
1.2 Baza e Vlerësimit.....	6
1.3 Data e Vlerësimit .....	6
<b>KAPITULLI II</b> .....	<b>6</b>
2.1 Vendndodhja.....	6
2.2 Përshkrimi .....	7
2.3 Pronësia.....	9
2.4 Sipërfaqja .....	9
2.5 Kushtet.....	9
2.5 Shërbimet.....	9
2.6 Urbanistika dhe Infrastruktura.....	9
<b>KAPITULLI III</b> .....	<b>11</b>
3.1 Vlerësimi.....	11
3.2 Metoda e tregut ose e shitjeve krahasuese.....	11
3.3 Vlera e Tregut të Lirë (Open Market Value).....	11
3.4 Vlera.....	12
3.5 Rezerva .....	13



### AKT-MARRËVESHJE

**Për:** Shoqëria "Belle Air" shpk, shoqëri në falimentim , përfaqësuar nga  
*Administratoria e Falimentimit të shoqërisë "Belle Air " sh.p.k. Znj. Shpresa Breçani*

**Nga:** Artur SULÇE dhe Etleva SELIMAJ

**Data:** 17.12.2020

**Lënda:** Marrëveshje Klient – Vlerësues për vlerësimin e pronës:

#### Kullotë

Nr. Pasurie 237/4 Zona Kadastrale Nr. 3096,

Sipërfaqja 18480.0 m<sup>2</sup>

Adresa: Qerekë , Krujë

Në pronësi të: Shoqërisë " Beller Air" shpk shoqëri në faliment

#### A. Instruksione

**Raporti do t'ju përcjellë opinionin tonë mbi vlerën e tregut të interesit ligjor.**

- *Përshkrim i pronës me dimensionet, vendndodhjen dhe gjendjen e saj sipas azhornimit të ri .*
- *Vlerësim i vlerës së tregut sipas kushteve të muajit Shtator 2020 – Dhjetor 2020.*
- *Një opinion të kushteve aktuale të tregut dhe të lëvizjeve aktuale, gjithashtu edhe ato të ardhshme të tregut për pronat në këtë zonë.*
- *Mendime e sugjerime shtesë mbi faktorë të tjerë që mund të ndikojnë materialisht mbi pronën, vlerësimin apo përdorimin e ardhshëm.*

Në rast se prona që po vlerësojmë ka kontratë qiradhënie, ndonjë pretendim, apo ndonjë interes tjetër mbi të, duhet të na vini në dispozicion dokumentacionin e detajuar përpara vlerësimit, sepse ato kanë efekt mbi pronën.

Në rast të kundërt do të përgatisim një vlerësim të vlerës së tregut, të interesit absolut të lirë nga përdoruesit.

---



## B. Qëllimi

**Ky Vlerësim ka për qëllim përcaktimin e vlerës aktuale të pronës:**

### **Kullotë**

**Nr. Pasurie 237/4 Zona Kadastrale Nr. 3096,**

**Sipërfaqja 18480.0 m<sup>2</sup>**

**Adresa: Qerekë , Krujë**

**Në pronësi të: Shoqërisë “ Beller Air” shpk shoqëri në faliment**

Për këtë qëllim do të zbatohet seksioni përkatës i Standardeve Evropiane të Vlerësimit. Në bazë të këtyre Standardeve, raporti i vlerësimit do të bëhet vetëm pasi ne të kemi inspektuar pronën.

Inspektimi dhe investigimet do të bëhen në bazë të rrethanave të përshtatshme dhe të mundshme të pronës dhe nuk do të jemi të detyruar të bëjmë studime gjeologjike apo të tjera të kësaj natyre.

Gjithashtu nuk do të kërkojmë të bëhen kontrole të infrastrukturës në këtë zonë.

### **Raporti do të përmbajë këto supozime:**

- *Prona është e lirë nga çdo barrë apo detyrim ligjor.*
- *Rezultatet e kërkimeve në Z.R.P.P. dhe në organet shtetërore nuk prekin pronën dhe vlerat e saj. Kushtet për përdorimin e tanishëm dhe të ardhshëm, janë të ligjshme.*
- *Mos-inspektimi i vendeve të veçanta nuk sjell asnjë ndryshim në vlerësim. Nuk do të kemi asnjë detyrim të verifikojmë këto supozime dhe do të bazohemi vetëm në informacionin e ofruar prej jush.*

Me raportin tonë kemi përgjegjësi vetëm ndaj Jush, si institucioni për të cilin është përgatitur ky raport vlerësimi. Raporti në asnjë pjesë të tij nuk mund të botohet pa aprovimin tonë me shkrim për formën dhe kontekstin ku do të përdoret.

Përvoja jonë në fushën e vlerësimeve është kryesisht në Prona të Paluajtshme të karakterit rezidencial, tregtar, industrial, për llogari të subjekteve private dhe shtetërore. Kontributi ynë shtrihet në të gjithë territorin e vendit tonë.

**Me sa jemi në dijeni nuk kemi asnjë konflikt interesi në përgatitjen e këtij raporti.**

Garantojmë që raporti do të vlerësohet me aftësinë Profesionale dhe Seriozitetin e duhur të një Vlerësuesi me licencë, sipas kritereve të përcaktuara nga TEGOVA (Grupi Evropian i Vlerësuesve të Pasurive të Paluajtshme) që është korporata e vendosjes së Standardeve të Vlerësimit të pronave brenda Komunitetit Evropian.

Vlerësimi i pronës që ju na keni rekomanduar do të bazohet në metodologjinë e vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme dhe në çmimet e tregut të lirë që përdoren sot në zonën ku gjendet prona objekt i këtij vlerësimi në Qerekë të Krujës duke marrë në konsideratë **Ofertë – Kërkesën** në Treg dhe **Zhvillimin** e Zonës.

**EKSPERT VPP Artur SULÇE**

**EKSPERTE VPP Etleva SELIMAJ**

### **Raport Vlerësimi**

Vlerësimi është përgatitur për interesat e institucionit tuaj (**Administratores së falimentit të shoqërisë Belle-Air shpk shoqëri në faliment znj. Shpresa Breçani**) dhe është bërë në përputhje me Manualin e Standardeve Evropiane të Vlerësimit.

Vlerësimi është konfidencial dhe vetëm në përdorimin tuaj, për qëllimet specifike të cilave u referohet.

Ai mund të përdoret nga këshilltarë të tjerë profesionistë për t'ju ardhur në ndihmë në lidhje me sa më sipër, por jo nga persona të tjerë.

As i gjithë dhe as ndonjë pjesë e këtij raporti apo referencë ndaj tij, nuk mund të përfshihet në ndonjë dokument të botuar, qarkore ose deklaratë, sikurse nuk mund të botohet pa miratimin tim, me shkrim për formën dhe kontekstin ku do të përdoret.

## **RAPORTI I VLERËSIMIT**

### **KAPITULLI I**

#### **1.1 Adresa dhe prona**

Prona objekt i këtij raport vlerësimi (lloji kullotë) ndodhet në Qerekë, Krujë.

---



### Foto Ajrore



#### 1.2 Baza e Vlerësimit

Opinioni ynë për vlerën e kapitalit të pronës, është bazuar tek vlerat e shitjeve, blerjeve dhe dhëniet me qira të pronave të ngjashme në zonën përreth, nëpërmjet Metodës së Krahasimit të Drejtpërdrejtë.

Sipas llogaritjeve të mundshme kemi dhënë vlerat alternative të saj.

#### 1.3 Data e Vlerësimit

Prona u inspektua në datë 14.12.2020 dhe vlerësimi u përgatit në datë 17.12.2020.

## KAPITULLI II

#### 2.1 Vendndodhja

Prona, ndodhet në fahatin Qereke, Krujë, në vije ajrore rreth:

1.300 m larg në jug-perëndim të qytetit të Krujës;

8236 m larg ne jug të Fushë Krujës;

12281 m larg ne veri-perëndim te qendrës sekryeqytetit;

41305 m larg ne veri-lindje të rreth rrotullimit tek Qaf-Kashar, ku kryqëzohet Autostrada Tiranë- Durrës me rrugën e re të Rinasit;

1500 m larg në jug te rreth-rrotullimit te rrugëve për në hyrjen e Aeroportit të Rinasit;

1200 m larg ne jug të hyrjes se Terminailt te Aeroportit Kombëtar " Nena Tereza";

700 m larg në veri-lindje te Univcrsitetit "EPOKA";

Zona, në të cilën ndodhet prona është një zonë rurale me zhvillim agrar, me toka bujqësore, krvesisht te llojit are, e cila pas viteve 1995 është zhvilluar ndërtime të tipit të vilave dy kateshe, lokale per Bare Kafe, Restorant, ambiente argëtimi e shp!odhëse, hotele dhe pika karburanti etj. Pra, prona ndodhet në një zonë rurale, e cila mbas viteve 1995, është zhvilluar me objekte komerciale, arsimore, industriale, rezidenciale dhe pika karburanti, ne te dyja e anet e rrugës kryesore Tirane-Rinas, gjë që i krijon pronës, mundësi të mira shfrytëzimi dhe për t'u zhvilluar si truall, me objekte komerciale, rezidenciale etj. Kjo për faktin se prona ndodhet në afërsi të kryeqytetit dhe Aeroportit të Rinasit, në një zonë me zhvillim të dukshëm nga viti në vit. Gjithashtu për zhvillimin e zonës ekziston një Masterplan paraprak dhe i ripunuar i Aeroportit "Nënë Tereza", i miratuar me Vendimin Nr. 1, date 15.07.2004 të KRRTSH. Studimi parashikon ndërtimin e objekteve te ndryshme polifunksionale si banimi, hotel:, njësi administrative, qendra tregtare etj.

Vendodhja dhe Genplani përfshihen bashkangjitur raportit, të cilat japin një ide më të qartë për vendodhjen e pronës dhe marëdhënien e saj me zonën përreth.

## 2.2 Përshkrimi

Prona që vlerësohet është një sipërfaqe toke e llojit "Kullotë", e pozicionuar në bllokun e parcelave bujqësore në terren fushor me pjerrësi 0-5 %, që shtrihen në

---



perëndim të Aeroportit Kombëtar "Nënë Tereza" dhe në veri të Rrugës Tiranë-Rinas.

Prona ka formë jo të rregullt gjeometrike, disakëndore me sipërfaqe 18,480.0 m<sup>2</sup>, me një shtrirje gjatësore veri-jug, në anën perëndimore të rrugës së aeroportit. Prona nuk është e rrethuar dhe as e sistemuar.

Gjendja e rrugëve që çojnë në Aeroportin e Rinasit është e mirë, pasi janë rrugë të reja dhe të mirëmbajtura, ndërsa rruga hyrëse në pronë është e shtruar me çakëll e pa asfaltuar, me gjerësi optimale për kalimin e mjeteve.

Komunikimi i pronës me rrugët e zonën përreth si dhe Terminalin e Aeroportit "Nënë Tereza", është i mirë, dhe realizohet nëpërmjet rrugës së shtruar me çakëll, me të cilën pronë ka akses të drejtëpërdrejtë në anën lindore të saj. Kjo rrugë, në skajin verior të saj lidhet me rrethrotullimin e rrugës në hyrje të Aeroportit.

- Veriu me pasurinë 246/2
- Lindja me pasurinë 246/2, 237/3
- Jugu me pasurinë 247/2
- Perëndimin me pasurinë 246/2 dhe 231/11





### 2.3 . Pronësia

Në bazë të Kartelës së Pasurisë së Paluajtshme për pronën: të lëshuar nga Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë , në datë 08.04.2011, ( fotokopje) , vërtetohet se Shoqëria “ Belle-Air “ shpk është pronare e Pasurisë Nr. 237/4, e llojit kullotë e ndodhur në Zonën Kadastrale Nr. 3096, Volumi 9, Faqe 55, në adresën Qerekë, Krujë me sipërfaqe 18,840 m<sup>2</sup> , me indeks e hartës K-34-88-(199- B).

Për efekt të vlersimit supozohet se prona është e plotë dhe se titujt e pronësisë janë të plotë dhe të sakte

### 2.4 Sipërfaqja

Sipërfaqja e përgjithshme e pronës sipas çertifikatës së pronësisë është 18,840m<sup>2</sup>.

### 2.5 Kushtet.

Nuk kemi kryer një mbikqyrje strukturale të pronës dhe komentet kufizohen vetëm në ato të një inspektimi sipërfaqësor që mund të bënim mbi pronën. Duke nënvizuar se prona është inspektuar vetëm nga niveli sipërfaqësor.

### 2.5 Shërbimet

Nga një inspektim sipërfaqësor duket se prona është e pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme.

Nuk kemi bërë inspektim për përshtatshmërinë, kushtet e këtyre shërbimeve dhe për pasojë nuk mund të komentojme me shumë.

### 2.6 Urbanistika dhe Infrastruktura

Prona aktualisht ka akses të drejtëpërdrejtë në anën e saj lindore me rrugën me cakëll e cila lidhet me Aeroportin “ Nënë Tereza” dhe me rrugën Tiranë-Rinas -Fushë Krujë.

Gjendja e rrugëve që lidhin me Aeroportin e Rinasit është e mirë, pasi janë rrugë të reja dhe të mirëmbajtura , ndërsa rrugët hyrëse në pronë është e shtruar me cakëll, e pa asfaltuar me gjërësi optimale për kalimin e mjeteve.


---



Komunikimi i pronës me rrugët e zonës si dhe me Terminalin e Aeroportit “Nënë Tereza”, është i mirë dhe realizohet me anë të rrugës me cakull, me të cilën prona ka akses të derjtëpërdrejtë në anën Lindore të saj. Kjo rrugë në anën Veriore të saj lidhet me rreth rrotullimin e rrugës hyrëse te Aeroportit.

Si pasojë prona ka komunikim të mirë me zonën përreth, me kryeqytetin dhe qytete të tjeratë vendit.

Gjithashtu pronësia përfshihet në Masterplanin Paraprak dhe të Ripunuar të Aeroportit “Nënë Tereza”, i miratuar me Vendimin nr.1, datë 15.07.2004, të KRRTSH-së.



### KAPITULLI III

#### 3.1 Vlerësimi

Te përgjithshme lidhur me vlerësimin.

Prona objekt i këtij vlerësimi plotëson kushtet për të patur vlerë, pasi:

- Plotëson kushtin për të qenë e zotëruar.
- Për efekt të këtij vlerësimi është supozuar se mbi pronën edhe pse është kolateral, nuk ekzistojnë kufizime statuale që pengojnë shitshmërinë apo përdorimin e saj.
- Ka një përdorim të tillë për të cilin krijohet kërkesë në treg.

Vlerësimi ynë është bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme, me Metodën e Krahasimit të Drejtpërdrejtë me çmimet e tregut të lire, sipas Manualit të Standardeve Evropiane të Vlerësimit.

Metoda e Krahasimit merr parasysh shitjet e pronave në zonën përreth si dhe shumat e afuara për blerje pronash të ngjashme me pronën që po vlerësohet.

Blerësit potenciale që kanë interes për pronën janë të kufizuar, duke pasur në konsideratë pozicionin në të cilin ndodhet, janë ata që kryejnë aktivitet brenda zonës së aeroportit dhe që i shërben asaj.

Nga rezultatet e vrojtimit të tregut të pasurive të paluajtshme është konstatuar rënie përgjatë vitit 2020, për shkak të situatës së pasigurtë që është krijuar nga Covid-19 dhe nga Tërmeti i muajit Nëntor 2019.

Sipas rezultateve të vrojtimit të Tregut të Pasurive të Paluajtshme dhe indeksit të çmimit të banesave sipas Bankës së Shqipërisë për gjashtëmuajorin e parë të Vitit 2020 shikohet se është ulur numri i pronave të shitura, është rritur koha mesatare e shitjes së një prone, çmimet kanë pësuar rënie dhe në periudhën afatshkurtër nuk ka optimizëm për përmirsim të situatës.

#### 3.2 Metoda e tregut ose e shitjeve krahasuese

Metoda e Tregut e përcakton “vlerën” nëpërmjet analizës së shitjeve të kaluara të pronave krahasuese. Metoda e Tregut bazohet në supozimin se blerësi i informuar nuk do të paguante më shumë për një pronë sesa kostoja për të blerë një pronë ekzistuese të të njëjtit përdorim. Në vlerësimin e pasurive të paluajtshme, prona të ngjashme të shitura së fundmi ose të ofruara për shitje në tregun aktual, analizohen dhe krahasohen me pronën që vlerësohet duke i bërë rregullimet për diferencat në faktorë të tillë, si: **koha e shitjes, vendndodhja, tipi, mosha dhe kushtet e përmirësimit dhe përdorimit perspektiv.**

#### 3.3 Vlera e Tregut të Lirë (Open Market Value)

Për të përcaktuar sa do të jetë çmimi i tregut (n.q.s. do të supozojmë se prona mund të shitet sipas një kontrate ndërmjet një shitësi të vullnetshëm dhe një blerësi në datën e vlerësimit,

duke supozuar se pasuria është ekspozuar publikisht në treg dhe ka pasur për këtë qëllim kohën e mjaftueshme në dispozicion, se kushtet e tregut lejojnë shitjen sipas natyrës së kësaj pasurie), është marrë parasysh informacioni nga tregu i pronave në zonën përreth si kushtet ashtu edhe gjendja në të cilën ndodhet prona që po vlerësohet. Vlera e tregut të lirë të deklaruar në këtë raport është çmimi i vlerësuar i kontratës së shitjes së cilës nuk i janë zbritur kostot e shitjes.

Vlera e tregut të lirë e kësaj prone është llogaritur në bazë të supozimeve të bëra gjatë këtij raporti. Në përcaktimin e Vlerës është marrë parasysh gjendja dhe niveli i tregut në zonën përreth pronës, gjendja fizike e pronës, vendndodhja e saj, kushtet në të cilat ndodhet prona ku në momentin e inspektimit prona ishte e amortizuar.

Për të dhënë një vlerë tregu reale për këtë pronë, përveç konfirmimeve të marra nga transaksionet në treg u interesova edhe në zyra imobiliare për çmimet e shitblerjeve në këtë zonë. Vlera e tregut sipas Komitetit Ndërkombëtar të Standarteve të Vlerësimit përkufizohet:

*“Vlera e tregut është shuma e vlerësuar, për të cilën një pronë shkëmbehet në datën e vlerësimit midis një shitësi të vullnetshëm dhe një blerësi të vullnetshëm, në një transaksion , ku palët nuk kanë lidhje me njëra tjetrën, pasi të jetë bërë marketingu i duhur, ku palët kanë vepruar me dijeni dhe kujdes dhe pa detyrim”.*

Për të arritur në konkluzionin e vlerës së tregut të kësaj prone, kemi studiuar situatën në të cilën ndodhet ajo. U bënë rregullime në funksion të vendndodhjes, kushteve, investimeve të kryera në të, standarteve të saj, sipërfaqes si dhe duke gjykuar që mbi këtë pronë është vendosur masë sekuestro-konservative .

### 3.4 Vlera.

Vlera e tregut të shitjes së lirë:

**Duke argumentuar dhe gjykuar për sa kemi shpjeguar më sipër, jemi të mendimit se për pronën :**

#### **Kullotë**

**Nr. Pasurie 237/4 Zona Kadastrale Nr. 3096,**

**Sipërfaqja 18480.0 m<sup>2</sup>**

**Adresa: Qerekë , Krujë**


**Në pronësi të: Shoqërisë “ Beller Air” shpk shoqëri në faliment**

- **Vlera e Tregut të Lirë, është:**

**Kullotët 18,480 m<sup>2</sup> me vlerë**

**554,400 Euro**

---



“Shuma e vlerësuar për të cilën një pronë shkëmbehet në datën e vlerësimit midis një shitësi të vullnetshëm dhe një blerësi të vullnetshëm në një transaksion normal pas një marketingu të përshtatshëm, në të cilin palët kanë vepruar në një mënyrë të vetëdijshme dhe pa detyrim”.

### 3.5 Rezerva

Vlerësimi është bërë në bazë të vlerave aktuale të ngjashme të tregut. Vlen të theksojmë së në këtë vlerësim është marrë parasysh arsyeja dhe vendi për të cilën është kryer vlerësimi, por nuk parashikohen ndryshimet që mund të pësojnë koeficientë të veçantë të vlerësimit në të ardhmen. Theksojmë gjithashtu se nuk kemi kryer një mbikëqyrje strukturale të pronës dhe komentet kufizohen vetëm në ato të një inspektimi sipërfaqësor që mund të realizonim. Kemi konsideruar të mirëqena dhe legale të gjitha dokumentet e paraqitura nga klienti.

**Kemi supozuar për qëllim të këtij vlerësimi, se :**


- a. Nuk ekzistojnë ndotje (ose kostoja e punës për pastrimet do të jetë e papërfillshme në vlerësim).
- b. Nuk supozohet asnjë përgjegjësi për ekzistencën e ndonjë ndotje, as për ndonjë ekspertizë apo kërkim shkencor të kërkuar për ta zbuluar atë.
- c. Nëse si rrjedhojë përcaktohet se ekziston ndotje në pronën subjekt ose në pronën fqinje ose nëse pronat kanë pasur ose kanë një përdorim që mund të ndotë, kjo mund të reduktojë vlerën e raportuar.

**EKSPERT VPP**                      *Artur SULCE*  
**EKSPERTE VPP Etleva SELIMAJ**



**Tiranë, më 17.12.2020**

TRS-216-413 Truall ne shitje ne Rinas, prane Tirana Business Park - Tirane



Property ID : TRS-216-413

Okazione, Shitje

60 Euro /m2 - Toka

4000 m2  Shto ne liste

Printo

Okazion per 30 dite

Truall ne shitje ne Rinas, prane Tirana Business Park.

Me nje siperfaqe 4000 m2, me ball 71 m dhe gjatesi 57 m.

Ndodhet ne zonen me planifikim miks me koeficient shfrytezimi

35% te bazes deri ne 5 kate.

E pershtatshme per cdo lloj biznesi , per ndertim magazinash,

hotele, fondacione, supermarkete etj.

Pozicionimi i kesaj prone ndodhet ne nje zone me nje zhvillim

urbanistik bashkekohor ku ne projektet afatshkurtra kalojne tramvaj, treni,

dhe levizja e pasagjereve Rinas-Bulevardi Zogu 1-re.

Distanca nga hyrja e aeroportit Nene Tereza 450 m.

Distanca nga Linja e Tramvajit e cila do kaloje nga Bulevardi i Ri ne Rinas dhe Durres 300 m

Avantazh i kesaj prone eshte pozicioni i saj prane Tirana Bussines Park ,

e cila mund te jepet me qera ose si aksioner per

kompanite e medha qe duan te ndertojne dhe te ushtroje aktivitet ne kete zone.

Me hipoteke.


Cmimi 60 euro/m2







Shitet Toke (12,180 m2) | Rruga e Aeroportit-Rinas

**524 000**  
**EUR**

~~600 000~~ EUR

Shitet nga: **N Blok** Dje 14:30 Fshini, ndryshoni ose ripërtërimi njoftimin tuaj




-  Lloji i njoftimit  
Shitet
-  Reklamuar nga  
Person fizik
-  Adresa  
Rruga e Aeroportit-  
Rinas
-  Sipërfaqe  
12180 m<sup>2</sup>
-  Për vendbanimin  
Tokë
-  Komuna  
Tiranë

Shitet Toke 12,180 m2 ne Rrugen e Aeroportit. Ne vije ajrore shume afer me Tirana Business Park dhe Aeroportin. Zone me plane te zhvillimit urbanistik ne te ardhmen e aferme.

**Okazon! Toke ne Shitje ne Rinas**

**130 000**  
**EUR**

Shitet nga: **Prone** Dje 15:39 Fshini, ndryshoni ose ripërtërimi njoftimin tuaj



-  Lloji i njoftimit  
Shitet
-  Reklamuar nga  
Person fizik
-  Komuna  
Tiranë

Shitet toke ne Rinas me siperfaqe 4500m2  
Ndodhet prane aeroportit Rinas.

## SHITET TOKE NE RINAS

1 EUR

**Njoftimi i kompanisë** Shitet nga: **BILLION G&G GROUP** 15 Dhj 10:42 Kycuni në kompani për të bërë ndryshime



Lloji i njoftimit  
Shitet



Reklamuar nga  
Kompani



Adresa/Rruga  
Rinas



Komuna  
Tiranë

Shitet Toka ne Rinas 3300m2. Toka ka pozicion strategjik mjaft te favorshem per çfaredolloj biznesi, ndodhet 200 metra larg rrethrotullimit te Aeroportit Nënë Tereza. Toka eshte buze rruge, afer bizneseve te tjera aty prane. Disponon dokumentacion te rregullt hipotekor. Per nje vizite ne kete prone ose prona te ngjashme kontaktoni Jonen ne nurmin 0692033500.  
<https://billionrealty.al/index.php/property/shitet-toke-ne-rinas-3/>



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
 ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

**ÇERTIFIKATË** 134708  
 PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit KRUJE Zona Kadastrale Nr. 3096  
 Numri i Pasurisë 237/4 Volumi 9 Faqe 55  
 Adresa e Pasurisë KRUJE, QERRECE  
 Lloji i Pasurisë KULLOTË  
 Sipërfaqja Totale 18480 (TETEMËDËHAT MIJE E (MËTA) (KALIFORNI) UAFRAN) (TETEMËDËHAT) (MËTA) UAFRAN  
 Nga kjo : Sa Truall \_\_\_\_\_ Nga kjo : Sa Ndërtesa \_\_\_\_\_  
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes \_\_\_\_\_ %

**KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË**

Zoti ( Zotërinjtë )

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
<u>SHOQERISE</u>			<u>-</u>	<u>TIRANE, SHESH</u>
<u>"BELLE AIR" SHPK</u>			<u>-</u>	<u>"SKEDHORENDE"</u>
			<u>-</u>	<u>-</u>
			<u>-</u>	<u>-</u>

- është pronar i PASURISE N° 237/4  
 - janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart \_\_\_\_\_  
 - është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi \_\_\_\_\_  
 - kufizimet e pasurisë janë : V 246/2, 246/2, 237/3, 247/2, P 246/2, 237/11

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së parartitur nga I (të) Interesuari (t) në datë 08.04.2011 Nr. 1744

Data e lëshimit të certifikatës 08.04.2011

Zyrtar i certifikatës  
 REGJISTRUESI  
 [Stampa dhe Shënime të Zyres së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë]  
 [Shënime dhe Firmat]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
Misioni | Posaçëri | Dhënie e Liçensave Profesionale për Licenca të Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme

Nr. regj. Vp.1672



L I C E N C Ë  
Profesionale Individuale

Miratur me Vendimin e Komisionit  
Nr. 5, datë 30. 05. 2019

PËR VLERËSIM TË PASURIVE TË PALUAJTSHME  
*Shkalla e parë*


**Z. Artur SULÇE**

PËR VLERËSIM NË FUSHËN:  
"inja teknologjike, makineri e pajisje "


KRYETARI

Arben DHIMA



 REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licensave Profesionale për Licenca të Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme

Nr. regj. Vp.1525



L I C E N C Ë

Profesionale Individuale

Miratur me Vendimin e Komisionit  
Nr. 5, datë 30. 05. 2018

PËR VLERËSIM TË PASURIVE TË PALUAJTSHME  
*shkalla e dytë*

**Znj. Etleva SELIMAJ (BALLABANI)**

PËR VLERËSIM NË FUSHËN:  
**“Ndërtesa dhe Tokë Truall”**

KRYETARI

Arben DHIMA

